



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra për Komunikim me Publikun
Kancelarija za Javno Komuniciranje
Office of Public Communication

THIRRJE PER APLIKIM

Për Pagesa Direkte për kulturat Bujqësore (Grurë,Misër, Luledielli dhe Farë Gruri) për vitin 2014

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të vazhdoj të mbështes sektorin e drithërave, përmes pagesave direkte për njësi të sipërfaqes së mbjellë me kulturën e grurit,fares per grure,miserit dhe lulediellit. Niveli i mbeshtetjes do te jete:

Pagesa Direkte-Grure: 125 €/ha

Pagesa Direkte-Fare gruri: 225 €/ha

Pagesa Direkte-Miser: 100 €/ha

Pagesa Direkte-Luledielli: 100 €/ha

Fermerët që aplikojnë per Pagesa Direkte duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Të jenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës;
- Sipërfaqet e mbjella me kulturën e grurit duhet të jenë minimum 2 ha;
- Parcelat e mbjella duhet të jenë minimum 0.20 ha;
- Sipërfaqja e tokës bujqësore, e cila është marrë me qira, duhet të dokumentohet përmes kontratës së lidhur ndërmjet palëve dhe përmes fletës poseduese;
- Sipërfaqja e marrë me qira duhet të jetë e kontraktuar së paku për një vit.
- Të kenë mbjellë së paku 1 ha tokë me misër në pronësi;
- Të kenë mbjellë së paku 1 ha tokë me luledielli në pronësi;
- Të kenë mbjellë minimum 5 ha dhe maksimum 100 ha me grurë për prodhimin e farës së grurit;
- Parcela e mbjellë me grurë për prodhimin e farës së grurit, duhet të jetë në minimum 1 ha e pandarë;
- Fara e mbjellur e grurit duhet të jetë në Listën e Lejuar të Farës;

- Sipërfaqja e tokës e marrë me qira duhet të jetë 1 ha e pandarë;
- Sipërfaqet e mbjella me grurë për fare duhen plotësuar kriteret gjate inspektimit fushor

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimin nga banka se llogaria është rrjedhese dhe aktive
- Dëshminë nga kadastra për sipërfaqen e tokës së punueshme në pronësi (fletenposeduese)
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Kontrata për sipërfaqen e marrë me qira, duke bashkangjitur fletën poseduese të qiradhënësit dhe
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 45 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike.

Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi përmes programit sLPIS.

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi

Të gjithë fermerët fillimisht, gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve, i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.

Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në nenin 30 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për pagesat direkte në lëmin e bujqësisë.

Sqarim:

Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

**Prishtinë
12.12.2012**